



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCESVERBAL

Nr. 1, datë 11.02.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:14

Data e mbajtjes së mbledhjes : 11.02.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përsëndetje të gjithëve!

Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Sot mbajmë mbledhjen e parë të këshillit për vitin 2025.

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë, do informohemi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare për vitin 2024 si dhe raportin 12 mujor të punës së Këshillit për vitin 2024. Materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj sekretaren të procedoj me apelin.

Dorina Milja: Fillojmë.

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri....

33 Këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Sot për shqyrtim janë 4 pika në rendin e ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL
Pika 3. Raport informimi Adrian Gurraa Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare	RAPORT MBI VEPRIMTARINË E ADRIAN GURRASË SË ARSIM, KULTURË, RINISË, SPORTEVE DHE KOMUNITETEVE FETARE PËR VITIN 2024
Pika 4. Raport informimi Kryetari i Këshillit	RAPORT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT 2024

- Kalojmë **në pikën 1-rë**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit Znj. Shemsi.

Edlira Shemsi : Përshëndetje !

Dëgjohe ?

Ani Dyrmishi : Po

Edlira Shemsi : Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit pasi mori në shqyrtim trajtimin e kriterëve për vazhdimin e ndihmës ekonomike të familjeve në nevojë të individëve që kërkojnë ndihmë ekonomike brenda fondit 6%, vendosi t'i kalojë këto kriterë. Gjithësesi unë doja të bëja një koment zoti kryetar, nëqoftëse më lejohet tani mirë, nëqoftëse jo në fund.

Ani Dyrmishi: Në lidhje me pikën?

Edlira Shemsi: Po në lidhje me pikën gjithmonë.

Ani Dyrmishi: Mirë.

Edlira Shemsi: Për kriteret që janë vendosur në bazë të vitit 2016 të ndryshuar në vitin 2019, për asistencë sociale në Republikën e Shqipërisë, me Vendimin 955, këto kriterë në fakt duhet thënë që janë të vendosura apriori ose edhe arbitrate mund t'i quaja, sepse jemi aktualisht akoma në gjendjen që nuk kemi të përcaktuar minimumin jetik dhe këto kriterë janë kriterë jo të sakta, sepse nuk pasqyrojnë nevojat reale të shtresave në nevojë që kërkojnë ndihmë të individëve dhe familjeve që kërkojnë ndihmë pranë Bashkisë Durrës dhe për rrjedhojë një pjesë jo e pakët e atyre që aplikojnë përjashtohen nga këto kriterë për të marrë ndihmën e nevojshme. Megjithatë ajo ndihmë në fakt është aq qesharake se është vetëm 30 000 lekë të vjetra në muaj, por edhe këto një pjesë e konsiderueshme nuk arrijnë ta marrin në bazë të këtyre kriterëve që janë kriterë arbitrare në llogjikën tonë, sepse thashë nuk kemi akoma të përcaktuar minimumin jetik sa i duhet një personi apo një familje për të prodhuar ato nevojat bazike për të jetuar.

Ky është komenti edhe pse ne e kemi dhënë votën për miratim pasi nuk do të bëhemi bllokues në kalimin e kriterëve që do të vazhdojnë për të dhënë në vazhdimësi ndihmat aq sa është, që thashë është një ndihmë minimalisht e pakonsiderueshme, por ne do ta votojmë. Për këtë koment që bëra është një koment që është i lidhur me gjendjen reale të njerëzve, që kërkojnë ndihmë ke bashkia dhe nuk e marrin atë, sepse janë këto kriterë përjashtuese, që nuk ja japin mundësinë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj. Shemsi.

Më falni dhe mua se bëm një gabim procedural se nuk votuam rendin e ditës.

Ta hedhim në votim.

Kush është pro rendit të ditës?

Kundras'ka

Abstënim ...s'ka.

Atëherë miratohet.

Pikën e parë e lexoi znj. Shemsi.

Koment tjetër ka?

Dritan Burgija: Po kisha një 2 pyetje.

Ani Dyrmishi: Po z. Burgija.

Dritan Burgija: Tani do ma jepni ju këtë mikrofonin apo më duhet të shtyp unë këtu?

Ani Dyrmishi: Mos e luj mo.

Dritan Burgija: Mos ta luj, në rregull.

Tani kjo është një pikë që është shumë e rëndësishme për qytetarët, që aplikojnë për ndihmë ekonomike. Natyrisht ndihma ekonomike është e pamjaftueshme për të, me atë shumë qesharake që jepet, por përderisa ka qytetarë që aplikojnë për këtë shumë, domethënë kuptojmë që njerëzit janë aq në nevojë sa i bën punë edhe ai 30 000 lekëshi apo 20 000 lekëshi sa është e përcaktuar. E dini shumë mirë që Partia Demokratike në programin e vet ndihmën ekonomike e premtojmë 200 euro për çdo njeri që është në nevojë.

Por tani për drejtorinë përkatëse kisha nja dy pyetje:

Si e përllogarisni masën e ndihmës ekonomike në bazë të një udhëzimi të vjetër, ku me ndryshimet që ka patur VKM 597/2019, referencat e masës së ndihmës ekonomike kanë ndryshuar? VKM-ja 597/2019 ka patur ndryshime duke e rritur masën e ndihmës ekonomike. Shembull viktimat e trafikimit sipas Udhëzimit nr.4/2017, është 3000 lekë, sipas VKM-së 597/2019 e përditësuar, është 9900 lekë.

Ti bëj të gjitha pyetjet edhe pastaj ...

Ani Dyrmishi: Po

Dritan Burgjia: Okej (okay).

A keni një udhëzim për indeksimin e masës të ndihmës ekonomike? Nëse po, a keni marrë masa të reflektohet në pagesat që përfitojnë familjet në nevojë, duke qenë se VKM-ja 597/2019 e përditësuar referon që: Masa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë përcaktohet sipas strukturës së familjes edhe shkon deri në 150 % e masës së pensionit social dhe e indeksuar. Masa e ndihmës ekonomike vlerësohet nga shërbimi social shtetëror sa herë indeksohet pensioni social. Dhe në bazë të këtij indeksi pensioni social është indeksuar në masën 4.1 % sipas VKM 52, datë 18.09.2024 dhe është 9710 lekë?

Këto janë dy pyetjet që kisha.

Kam dhe një tjetër për familjet rome.

Si e zbatoni ligjin për këto familje, kur ka probleme të tilla si: Duke qenë se VKM 597/ 2019, cilëson që familjet paraqesin dokumnetacion në njësitë administrative ku kanë vendbanimin. A sjell kjo abuzim me fondin e ndihmës ekonomike dhe keqpërdorimin e tij? Na e shpjegoni pak këtë pikë duke qenë se ata lëvizin shpërngulen dhe....

Këto kisha.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Po, Meme mund të flasësh tek ai mikrofon.

Meme Xhaferaj: Ndjesë, sepse ishim në një takim tjetër. Jemi në një proces duke hartuar “Planin Social” dhe ishim me ekspertët, që po punojnë për këtë gjë dhe nuk i dëgjova në fakt të gjitha pyetjet.

Por nisur nga pyetja e fundit që kapa tani në lidhje me procedurën e aplikimit, ajo është standarte se si aplikohet dhe çdo familje aplikuese në të vërtetë verifikohet. Dhe këtu nuk bëhet fjalë që ne të miratojmë kriteret dhe për të qenë abuziv, por bëhet fjalë që ne në këto kritere që miratojmë t’i japim mundësinë atyre familjeve, të cilat nuk përfitojnë me fondet që alokohen nga shteti, por ne

t'ju përgjigjemi atyre që realisht janë në nevojë dhe për shkak të mundësisë dhe sistemit të pikëzimit ato janë të përjashtuara.

Ani Dyrmishi: Tan, të lutem mund të vazhdosh dhe një herë nga e para me pyetjet.

Dritan Burgija: Kanë lidhje me indeksimin e masës së ndihmës ekonomike.

A keni marrë masa të reflektohet në pagesat që përfitojnë familjet në nevojë duke qenë se VKM 597 e 2019, e përditësuar referon që: Masa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë përcaktohet sipas strukturës e së familjes që shkon deri në 150% e masës së pensionit social dhe të indeksuar? Masa e ndihmës ekonomike indeksohet nga shërbimi social shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeski pensioni social është i indeksuar në masën 4.1 % në VKM 52, datë 18.09.2024 dhe është 9710 lekë.

Meme Xhaferaj: Indeksi sigurisht që bëhet jo vetëm për familjet që janë përfituese sipas skemës së shtetit, por ne kemi të detyrueshme edhe për fondin 6% që ne përfitojmë nga kjo skemë nga 6%-shi patjetër që bëjmë indeskimin. E bën punonjësi social i njësisë, direkt administratori shoqëror.

Dritan Burgija: Për këtë e kisha fjalën e gjithë procedura është e varur dhe e ka në dorë një punonjës social

Meme Xhaferaj: Jo, absolutisht jo.

Dritan Burgija: Kjo lë vend për diskutim, sepse punonjësi social dikë e trajton si të nënës e dikë tjetër si të njerkes.

Meme Xhaferaj: Jo, absolutisht që jo...

Ai bën një vlerësim real të nevojave, ai është më pranë komunitetit, ai është kompetent dhe në aplikimet të ndihmës ekonomike, ai ka aftësinë të bëjë të gjithë komentet e nevojshme për ato rubrika që ndoshta nuk janë të aplikimi, por kur sheh një kusht të vështirë ai është i detyruar ta pasqyrojë atë gjë. Nëse është një familje nga komuniteti rom ka disa nevoja specifike duhet t'i pasqyrojë dhe t'i referojë dhe nëse ne nuk mundemi t'i mbulojmë nga skema e ndihmës ekonomike kemi detyrimin për t'i referuar dhe për shërbime të tjera. Gjithë vendimi është që ne familjes t'i referojmë gjithë nevojat dhe t'i ndihmojmë me shërbime, nuk bëhet fjalë për raste abuzive. Skema e Durrësit është në nivele të tilla që vërtetë ndihmën e marrin familjet që janë në nevojë. Kjo ka vite pasi bashkia e Durrësit ka punuar dhe me punët në komunitet me qëllim pastrimin e skemës nga rastet abuzive dhe këtë unë e them me përgjegjësi këtu nuk bëhet fjalë që të përfitojnë raste abuzive, por të përfitojnë realisht familjet në nevojë.

Dritan Burgija: Unë uroj që të jetë kështu, por edhe ju në fjalën tuaj ju referuat punonjësit social Thatë : ai e ka në dorë, ai bën procedurën, ai.... ai....

Meme Xhaferaj: Po aplikimin...

Dritan Burgija: Tani problem është që, një pyetje po shtroj nuk po trajtoj probleme abuzive...

Meme Xhaferaj: Jo, jo apsolutisht.

Dritan Burgija: Se nuk kam fakte, nuk kam raste...

Meme Xhaferaj: Me gjithë respektin, patjetër.

Dritan Burgija: Domethënë unë thjesht, po trajtojmë një problem këu që nëse një punonjës social i interesuar për dikë është e shikon me prioritet, një familje e shikon me prioritet dhe tjetrën jo kjo është domethënë, e kemi që çdo gjë, gjithë procedura është bazuar në një person të vetëm apo në një grup pune. Kështu që ne jse, neve siç e nisa fjalën time, duke qenë se njerëzit janë shumë mezi e presin këtë ndihmën sociale derisa të ndërrohen pushtet që t'ia bëjmë 200 euro ndihmën ekonomike, neve do ta votojmë pro vetëm për t'ju ardhur në ndihmë me aq mundësi sa kemi të gjithë këtyre njerëzve.

Ani Dyrmishi: Faleminderit, zoti Burgija.

Meme Xhaferaj: Jo ne miratimin e sjellim në këshill bashkiak atë që sjell punonjësi administrator shoqëror, ne i sjellim këtu për t'i miratuar si me vlerë në bazë leku edhe nevojat e familjes.

Dritan Burgija: Ju i sillni në këshill bashkiak, por ne list shohim, ne nuk ndjekim procedurën se si është bërë nga punonjësi social, kështu që mos ta vazhdojmë këtë...

Meme Xhaferaj: Unë këtu jam....

Ani Dyrmishi: Faleminderit zonja Xhaferaj.

Faleminderit zoti Burgija

Koment tjetër?

Kalojmë në votim kush është pro...

Po Flutura?

Flutura Kasa: Tashi i dëgjova kriteret desha të bëj një pyetje. A ndikoni ju ose bëni ndonjë punë më të avancuar për të ndikuar në rritjen e kësaj pagese që i bëhet familjes në nevojë? Që të paktën të rritet edhe pak që të gëzohen ato deri kur të vijë 200 euro-shi.

Meme Xhaferaj: Këtë ne nuk e kemi në dorë, por në momentin kur rriten, kur ka për ndryshime ligjore për të arritur një strategji të japim opinionet tona në ministritë apo kemi shkuar dhe ke Avokati i Popullit për të dhënë rekomandime lidhur me përmirësimet në sistemin e vlerësimit për rastet me ndihmë ekonomike. Ose edhe për rastet që janë ekstremisht të varfër mund të miratojmë

po me këshill bashkiak për raste të veçanta ndonjë mbështetje të menjëhershme për t'ju referuar nevojës që ato mund të ketë familja apo individi.

Flutura Kasa: Faleminderit

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Atëherë koment tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike Znj. Feshti.

Marsida Feshti : Përshëndetje !

Komisioni i Strehimit Shërbimeve Publike është dakort për pikën 2 që të kalojë për miratim në këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 2 ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra? ... 1, 2, 3 ,.....5 kundra.

Dritan Burgija: Ngrejini dhe njëherë kundra.

Ani Dyrmishi: Ngrejini dhe njëherë kundra, t'i shohim.

Eda ça është ajo? Kundra apo ...?

Edlira Shemsi : Më falni.

Ani Dyrmishi: 1, 2, 3, 4, 5..... 10 kundra

23 vota pro dhe 10 kundër miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 3**. I japim fjalën z.Adrian Gurra.

Ardian Gurra (Drejtor i DAKRKF) : Atëhere përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Adrian Gurra, Drejtori i Arsimit, Kulturës të bashkisë së Durrësit. Me pjesën më të madhe tuaj, përveç njohjes që kam në këshilli bashkiak si detyrë time për të raportuar përpara jush për të gjitha detyrat dhe problematikat që ka zyra ime, jam njohur në dëgjuesën publike ku një pjesë e madhe juaj ka qenë prezent në relatinin që kemi bërë ne, në këto dëgjesa që janë detyrimi ynë ligjor dhe shpreh një falenderim të madh timin që edhe pse në rreshtime të ndryshme politike

kemi pasur një njëzëshmëri për të bërë më të mirën e mundshme në punët e arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve.....

(...Lexon raportin e dorëzuar me shkresë nr, prot 445/1, datë 07.02.2025 pranë Sekretarisë së Këshillit, i cili i është bërë i ditur këshiltarëve me email....)

Atëhere po e mbyll edhe me kulturën. Durrësi në dijeninë tuaj është një qytet që ka një përbërje një mozaik demografik dhe ne jemi përpjekur që të gjithë kalendarët kulturor t'i përgjigjemi grupeve të ndryshme me porcione kulture. Në fakt detyrë kryesore e bashkisë së Durrësit nuk është hartimi i këtyre kalendarëve, është strategjia për të dhënë shembujt private, se ne sot kemi. përgatitur kemi zgjedhur, kemi si model projektin që ne kemi aspiruar ta kemi udhërrëfyes tonin Sot privati i bën gjërat më mirë se shteti, shteti këtë radhë bashkia e Durrësit jep kampione se si bëhet, është filtri që lejon ose nuk lejon që aktiviteti të jetë brenda asaj cilësie që ne e induktojmë vet dhe tërë kohës. Nëqoftëse do të shihni në kalendarin kulturor ka aktivitete të tilla që fillojnë që nga kultivimi i muzikës së dhomës, muzikës operistike, kemi shkuar deri këtu, deri këtu e kemi çuar këtë radhë, muzika i shkon përshtat sezonit veror, i shkon më tepër edhe të ardhurve të shumtë, turistët e shumtë që kanë ardhur për Durrësin. Po kështu edhe aktivitete sportive si prej dy vite bëhet përshëmbull një “arena e boksit”, që përtej një ngjarje sportive është një ngjarje kulturore . Pak a shumë kjo është panorama, me pak fjalë, domethënë.

Ngaqë janë 5 drejtori.

Anisa Ibraj : Përshëndetje !

Unë kam dy pyetje . Meqenëse e paskeni në fokus rindërtimin, cilësinë e arsimit si ka mundësi që gjimnazi “Naim Frashëri” i ndërtuar së fundmi u përmyt ditën kur kishte reshje të shumta në Durrës, domethënë u përmyt kati përdhes, klasat filluan të pikojnë. Dhe si ka mundësi në shkollën 9 vjeçare “Abedin Dino”, klasa e 7 ka rreth 2 muaj që nuk zhvillojnë mësimin e matematikës, sepse nuk ka mësues, meqë e paske në fokus arsimin dhe cilësinë e arsimit.

Adrian Gurra: Atëhere, duhet të kesh qenë e vëmëndshme kur unë kam folur për cilësinë e arsimit, të thashë që bashkia e Durrësit është në një hap me Zyrën Vendore të Arsimit për të bërë më të mirën e mundshme për përmirësimin dhe shërbimin. Ne jemi pjesë e shërbimit ne nuk marrim pjesë në elementet kurrikular, ne nuk bëjmë politik...

Anisa Ibraj : Gjithmonë mburreni për gjimnazin “Naim Frashëri” dhe.....

Adrian Gurra: Një minutë...

Anisa Ibraj: Si ka mundësi tani me këto kushte bashkëkohore përmytet gjimnazi i saponërtuar?

Adrian Gurra : E mbarove, e mbarove pyetjen?

Anisa Ibraj: E mbarova ...

Adrian Gurra: Atëhere dëgjo përgjigjen.

Anisa Ibraj: Nuk po më jepni përgjigje pra, ju po mburreni dhe krenoheni tani këtu....

Adrian Gurra: Më dëgjo e nderuar, e nderuar këshilltare unë nuk tu mburra, unë nuk tu mburra në asnjë moment unë çdo gjë që relatova para jush...

Anisa Ibraj: E mora përgjigjen e mora përgjigjen, përgjigja është e dukshme po thjesht ...

Adrian Gurra: Dëgjo do kesh një jetë të gjatë për të bërë pyetje dhe për të marrë përgjigje. Unë kam detyrimin para të gjithë këtyre që për pyetjen që bëre ti, t'i kthej përgjigje pjesës tjetër. Atëhere po them dhe një herë tjetër, Durrësi vërtet u përmyt, unë mund të kem një përgjigje shumë më të thjeshtë për ta thënë, se nuk është pjesë e drejtorisë sime se çfarë ndodh kur përmytet Durrësi, sikundër nuk është pjesë e Drejtorisë së Arsimit Kulturës për të parë nëse një mësues matematike shkon apo s'është, kjo nuk është pjesë. Bashkia Durrës nuk merret me rekrutimin e kontigjentëve.

Anisa Ibraj:nuk dëgjohet se flet pa mikrofon.....

(Kryetari nuk i ka dhënë të drejtën e fjalës)

Adrian Gurra: Zonjë, zonjushë të lutem me dëgjo. Unë të respektova të dëgjova.

....Shumë zhurmë....

Adrian Gurra: Epo mirë tani unë dua të them një përgjigje ti se dëgjon, atëhere

Ani Dyrmishi: O Anisa leje pra ta mbarojë përgjigjen gjithë kohës debat këtu.

Adrian Gurra: Tani unë të jap përgjigjen dhe ti nuk kupton çfarë them unë...

Po them dhe një herë tjetër pyetjen e parë që ke bërë për përmytjen e Durrësit unë nuk e kam në pjesë të drejtorisë time. Është përmytur një Durrës i tërë dhe ti mund të thuash u përmytën varrezat, u përmytën këto, është një fenomen që i ndodh një qyteti që i ka një fenomen të tillë.

Anisa Ibraj: Unë po flas për gjimnazin...

Adrian Gurra: Po kjo nuk e bën dhe nuk e ç'bën të mirën që themi për cilësinë dhe pjesën e ndërtimit brenda standartit të një shkolle, iku kjo, se kemi dhe një makinë shumë të mirë që gjendet në rrugë dhe përmytet ne do shajmë makinën, makina ajo është, po pse përmytet është tjetër gjë. Një, e dyta përsa i përket rekrutimit të kapaciteteve pedagogjike në rastin në fjalë një mësues matematike nuk është, nuk e administrojmë ne portalin "Mësues për Shqipërinë" për sistemin e arsimit parauniversitar.

Anisa Ibraj: A nuk është detyra juaj?

Adrian Gurra: Nuk është detyra jonë po s'ke durim të dëgjosh, prandaj po them që nuk është.

Anisa Ibraj: Po si nuk qenka detyra jonë domethënë

Adrian Gurra: Po s'është pra e imja, duhet të shkosh diku tjetër ta bësh këtë...

Anisa Ibraj: Po shkolla është pjesë e bashkisë tonë?

Adrian Gurra: Po nuk jam unë moj ti, mund të më kërkosh llogari mua edhe pse gju dikush një penallti atje dhe se bën, po kjo nuk është detyrimi im.

Flutura Kasa: Se na çave kokën 2 orë , dëgjoje pra këtë që flet....

Anisa Ibraj: Të na japi përgjigjen pastaj e dëgjoj.

Flutura Kasa: Po si ka bashkia pra në varësi mësuesit që të shkojnë me dhënë mësim..

Ilir Paja: Mund të përgjigjem unë.

Ani Dyrmishi: Po, Ilir.

Ilir Paja: Nuk është përmbytje të jemi realisht se unë jam pjesë prej 22 vjetësh atje, shkolla ka dalë super shkollë, i ka të gjitha parametrat. Gjëra të vogla që kanë ndodhur, kanë ardhur të firmës menjëherë në çast dhe nuk ka ndodhur gjë, por ne e kemi tendencën për t'i zmadhuar me përmasa përmbytjesh dhe nuk ka përmbytje, hiqeni fjalën përmbytje. Tani unë po flas shumë hapur dhe përveç meje që kam qenë aty, nuk besoj ta dijë askush prej jush, por nuk ka qenë përmbytje janë gjëra të vogla, të cilat janë shmangur shpejt dhe përpos asaj nuk ka ndodhur dy tre herë, një herë të vetme dhe u morën të gjithë masat. Pra po të them me një bindje shumë të madhe se kam qenë vet aty, nuk e di nëse don përgjigje tjetër por unë po të jap diçka

Flutura Kasa: Po ai mësuesi pse nuk shkon me dhënë mësim?

Anisa Ibraj: Po se nuk ka mësues ...

Ilir Paja : Për çfarë?

Flutura Kasa: Pse nuk shkon me dhënë mësim matematike ai mësuesi?

Ilir Paja: Për çfarë po pyet se,,,

Nurië Gjoni : Se ka me ty, e ka per gjë tjetër.

Ilir Paja: Aaa e ka për gjë tjetër, në rregull më fal.
Jo mendova se mos ishte...

Ani Dyrmishi: Ilir, të lutem.
Po Hekuran.

Hekuran Merkola: Faleminderit zoti kryetar!

Faktikisht unë desha të ndaj një pyetje për drejtorin përkatës. Dua të ndaloj ke kopshtet dhe çerdhet, sepse është çështje shumë sensitive për qytetarët. Për hir së vërtetës kopshtet dhe çerdhet e bashkisë së Durrësit i konkurojnë kopshtet dhe çerdhet private në kushte, në cilësi, në të gjitha, por ajo që ve re unë dhe që ka nevojë për përmirësim. Nuk e di a është bërë rregullorja e re?

Adrian Gurra: Është bërë, sapo e thashë..

Hekuran Merkola: Ke rregullorja e re unë kam qenë në dëgjësë dhe kemi ngritur me forcë që të shtohet orari të shkojë deri në 5:30, sepse...

Adrian Gurra: Orari aq është.

Hekuran Merkola: Tek rregullorja e vjetër nuk ka qenë kaq. Për arsye se kjo është arsyeja e vetme që qytetarët detyrohen t'i çojnë fëmijët në kopshte private për shkak të orarit. E para dhe e dyta në kopshtet nëpër fshatra të verifikohet ose të kontrollohet orari se kur e lejnë punën edukatore. Dhe kjo mendoj duhet ta rishikojmë, sepse ka shumë vërejtje. Për të tjerat pastaj jam shumë dakort me këtë raport.

Adrian Gurra: Ne kemi një plan pune, ngaqë shtrirja territoriale e bashkisë së re të Durrësit ne nuk na mundëson dot të ketë një kontroll kaq permanent saqë ta kontatojmë, prandaj këto, prandaj këto ne i quajmë kopshte varësie dhe drejtorët e shkollave e kanë të tërë tagrin për të kontrolluar dhe për të na sqaruar, për të na dhënë për të na, për këtë, kështu që ne nuk mundemi dot. Se nëqoftëse ka ndonjë njoftim të veçantë përshëmbull diku është shkelur jashtë mase, ne shkojmë ndërsa drejtorët e shkollave e kanë të gjithë targrin për ta ndjekur këtë me gjithë konsulencat që kanë.

Hekuran Merkola: Ok, orari është?

Adrian Gurra: Orari është 5:30.

Ani Dyrmishi: Znj. Keçi.

Arjeta Keçi: Atëhere kam një ankesë nga komuniteti në fakt, duke qenë se e kam shkollë të lagjes, shkolla “Bedrie Bebeziqi” përpara se të bëhej shkolla e re që është e bukur shumë po ta shikosh ka pasur 18 klasa dhe nuk ka pasur turn mbasdite, sot ka 16 dhe 2 klasa e bëjnë mësimin mbasdite, përveç kësaj nga klasa e parë në të nëntë, janë tre orë edukimi fizik në javë, që i bie 54 orë edukimi fizik në javë, ndërkohë shkolla nuk ka palestër. Nuk di si do zgjidhet? Dhe ato kur është kohe e mirë e zhvillojnë jashtë. Ama nuk e di se si do të zgjidhet kjo ?

Adrian Gurra: Mund të jap një sqarim?

Arjeta Keçi: Po

Adrian Gurra: Gjithmonë ngaqë në derën time shkruhet Drejtoria e Arsimit në fakt shigjetohem ose vijmë ankesa që kanë të bëjnë me një menaxhim që bëhet nga Zyra Vendore e Arsimit, por unë duke pas prirjen që të jap përgjigje për çdo lloj pyetje edhe të zonjushës që ke pranë o duhet të hyjë në kuptimin tuaj, sepse kjo pjesë në detyrën e projektimit ka qenë pikërisht, se shkolla “Bedrie Bebeziqi”,

Joniada Musaraj: Aq e ka sipërfaqen .

Adrian Gurra:dhe përshtatja që i është bërë asaj ka qenë më e mira e mundshme për të pasur dhe palestër.

Joniada Musaraj: Duke patur edhe labrator, edhe bibliotekë.

Adrian Gurra: Por ne e kërkojmë brenda asaj njolle ne i kërkojmë të gjitha. Është më e mira e mundshme atje, se kanë qenë dhe arkitektët më të mirë aty se unë kam qenë pjesë në detyrën e projektimit që është dhënë për atë shkollë për shkak edhe të një simbioze që kam, edhe këtej edhe këtej, me inxhinerin dhe ka qenë më e mira e mundshme me u bërë. A bëhet më mirë se aq? Jo, është më e mira e mundshme.

Joniada Musaraj: Në atë sipërfaqe.

Adrian Gurra: Se aq sipërfaqe ka.

Arjeta Keçi: Si do zgjidhet problemi?

Adrian Gurra: Ma thuaj ti mua si ta zgjidhim, që ta bëjmë më mirë pra.

Ajo është shkollë që është një fat në mes të, në mes të Durrësit, sepse sot me standartet e reja që ka ministria se si duhet të bëhen shkollat raportet ndërmjet parcelës së shkollës dhe njollës së shkollës ne s’kemi dot mundësi ta bëjmë kështu që shqyr që kemi një “Bedrie Bebeziqi” në mes të Durrësit, kemi një ”Jusuf Puka “, të gjitha këto që shfryjnë pak.

Po duash ta zgjidhim hajt ta zgjidhim, por ti je vet kontigjent.

Burgija.

Dritan Burgija: Po.

Unë të përgëzoj një herë për sytë që ke që lexoje nga atje deri ke monitori.

Adrian Gurra: Po ky është vetëm fillimi.

Dritan Burgija: Unë kisha një dy pyetje, pasi kemi lëviz pak në zonë në këtë kohë dhe na e kanë ngrit si shqetësim qytetarët. Shkolla “Met Hasa” në Porto-Romano me çka pashë unë në tabelat që paraqiten është në proces.

Ardian Gurra: Qartë.

Dritan Burgija: Po po dakort, po është në proces domethënë po rindërtohet ë, me fondet e rindërtimit apo? E kisha gabim? Gjithashtu edhe shkolla.....

Gentian Kallmi: Më falni për ndërhyrjen po...

Dritan Burgija: Nuk ishte...

Gentian Kallmi: Nuk ishte shkolla...

Dritan Burgija: Ok atëherë shkolla e Vadardhës më duket se e dëgjova mire, që ishte me fondet e rindërtimit

Gentian Kallmi: Shkolla e Vadardhës është objekt rindërtimi i financuar me fondet e bashkisë.

Dritan Burgija: Nuk është proces rindërtimi?

Gentian Kallmi: Është objekt rindërtimi që do të rindërtohet me fondet e bashkisë.

Dritan Burgija: Janë klasifikuar nga Instituti i Ndërtimit?

Gentian Kallmi: Për shëmbjen.

Dritan Burgija: Për shëmbjen?

Gentian Kallmi: Po

Dritan Burgija: Deri në çfarë periudhe kanë funksionu këto 2 shkolla me nxënës?

Gentian Kallmi: Është një informacion që unë se kam, unë thjesht saktësova....

Dritan Burgija: Kam përshtypjen aty të paktën shkolla “Met Hasa”, që mua më bien me kaluar shpesh, di që ka funksionuar deri vonë me nxënës. Dhe nëse është klasifikuar DS4 apo DS5.....

Gentian Kallmi: Më fal se ju rindërpres.

Dritan Burgija:..... si është e mundur që ka funksionuar me nxënës brenda...

Gentian Kallmi: Më fal se ju rindërpres, shkolla Met Hasa nuk është në proces rindërtimi është me fondet e bashkisë Durrës, shkolla Vadardhës është në kuadër të procesit të rindërtimit dhe është me fondet e bashkisë.

Dritan Burgija: Për shkollën e Vadardhës nuk e kam informacionin dhe Ju s’ma jepni dot deri kur ka funksionuar.

Gentian Kallmi: Dhe unë të sqaroja pak më para që shkolla Met Haska është në rindërtim me fondet e bashkisë Durrës.

Dritan Burgija: Dakord, dakord nuk e kisha ke fondet.

Gentian Kallmi: Jo, jo okej (okay).

Dritan Burgija: E kisha thjesht domethënë që ka funksionuar me nxënës brenda, ndërkohë që është klasifikuar nga Instituti i Ndërtimit.

Gentian Kallmi: Nuk është e vërtetë sepse nuk është në kuadër të procesit të rindërtimit.

Dritan Burgija: Okej, okej pyetje e kisha, nuk është që.....
Vadardha thatë është klasifikuar?

Gentian Kallmi: Po.

Dritan Burgija: Është me fonde të rindërtimit.

Gentian Kallmi: Është në kuadër të procesit të rindërtimit me fondeve e bashkisë.

Dritan Burgija: Ma thua dot se si është klasifiku apo, domethënë për prishje DS5?

Gentian Kallmi: Po dhe shkolla e Vadardhës, po rindërtohet në një njollë tjetër jo aty.

Dritan Burgija: Shqetësimi i atyre banorëve atje që natyrisht nuk janë ekspert të fushës, thonë që shkolla nuk ishte për tu prishur, mund të shërbente duke qenë se shkolla nuk po rindërtohet tek

vendi ku ishte, mund ai objekt mund të shërbente shumë mirë për atë komunitet për shumë gjëra të tjera. Për gjëra që ato kanë nevojë si Qendër Shëndetësore apo ku di unë çfarë mund të kishte. Ky është shqetësim këtu po flasim për fjalën e banorëve atje, nuk po flas me fjalët e mija.

Gentian Kallmi: Atëhere nuk është kompetencë e bashkisë Durrës për të vlerësuar prishjen e një objekti.

Dritan Burgjia: E kuptoj, dakord.

Ani Dyrmishi: Atëherë koment tjetër s'ka , kalojmë **në pikën 4.**

Përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, për të mos u zgjatur po e shpreh në vija të përgjithshme, pasi më të detajuar e keni në raport, që besoj e keni lexuar të gjithë.

Të nderuar këshilltarë !

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi mbledhjet e këshillit, mbledhjet e komisioneve, vendimet e marra dhe konsultimet publike.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role duke u bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Për periudhën janar – dhjetor 2024, janë marrë 119 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak.

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:

- | | |
|--------------------------------------|--------------|
| 1. për probleme financiare | - 19 vendime |
| 2. për probleme sociale | - 13 vendime |
| 3. për infrastrukturën dhe strehimin | - 46 vendime |
| 4. për problemet urbane dhe asetet | - 21 vendime |
| 5. për emergjencat civile | - 3 vendime |
| 6. për probleme të arsimit kulturës | - 7 vendime |
| 7. të ndryshme | - 10 vendime |

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, konkretisht për familjet përfituese në kuadër të procesit të rindërtimit.

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës kanë qënë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky Këshill për 12 mujorin e vitit 2024 institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 9 mbledhje të radhës, 2 mbledhje jashtëradhe dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakondshme. Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare, ndërsa për komisionet i është tërhequr disa herë vëmendja për pjesmarrje në komisione.

Kemi përditësuar faqen online e Këshillit Bashkiak, gjithashtu në rrjetet sociale kemi bërë njoftimet për mbledhjet dhe kemi marr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjërime nga qytetarë të ndryshëm.

Nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e Bashkisë Durrës dhe përcjellja e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe në seancat plenare të këshillit. Gjatë mbledhjeve plenare të këshillit kanë marrë përgjigje 28 kërkesë-ankesa.

Pjesë e transparencës dhe llogaridhënies ishte edhe organizimi i “*Sesionit Informues*” të Këshillit të Bashkisë që u zhvillua në sallën e këshillit ku pati për qëllim:

- Informimin për veprimtarinë tonë për periudhën pak më shumë se 1 vjeçare që nga konstituimi i Këshillit dhe dëgjimin e opinionëve dhe rekomandimeve të komunitetit me qëllim përmirësimin e punës sonë.
- Ky takim u transmetua drejtpërdrejt (live) në rrjetet tona sociale.

Këshilli në bashkëpunim me bashkinë ka mundur të zhvilloj dëgjesa publike për pika të veçanta të rendit të ditës, si plani i arsimit parashkollor, parkimi publik, buxheti etj..

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në komunitetin ku ai banon apo përfaqëson para se të gjykohej apo shqyrtohet për të.

Nuk po e zgjas më shumë, me kaq po e mbyll. Për çdo sygjërim jemi të hapur të përmirësojmë punën e këshillit. Faleminderit të gjithëve.

Kontjana Kuçi : Kryetar me leje?

Ani Dyrmishi : Po zonja Kuçi.

Kontjana Kuçi: Kam dërguar një email, një kërkesë për vënien në dispozicion të disa dokumentacioneve, në e-mailin zyrtar të kryetares së bashkisë, Drejtorisë së Kabinetit edhe Drejtorisë së Buxhetit në bashki në lidhje me zbatimin e buxhetit për vitin 2024 si dhe zbatimin e rekomandive të Kontrollit të Lartë të Shtetit nga auditimi i fundit në Bashkinë Durrës. Nuk kam marrë përgjigje pamvarësisht që ka kaluar 2 muaj që nga kërkesa e parë dhe 30 ditë nga kërkesa e dytë që kam bërë. Në rast se duhet me e bërë kërkesën me shkrim, zyrtare me shkresë okej (okay) më thoni që ta përsërisim dhe një herë për herë të tretë, në rast të kundërt nuk do të kërkohej që të vinte përgjigja të paktën me email duke qenë se unë si përfaqësuesja e grupit e kam bërë këtë kërkesë 2 herë.

Ani Dyrmishi: Në lidhje me pyetjen tuaj, faleminderit.

Përsa i përket kërkesës së pyetjes nuk mendoj që është pjesë e këtij diskutimi, sepse është jashtë rendit të ditës, plus që përgjigjen do e marrësh kur të jetë dhe kryetarja e bashkisë prezent që të japi dhe...

Kontjana Kuçi: Shpresoj që të përcillet të paktën.

Ani Dyrmishi: Shqetësimi normalisht do përcillet.

Faleminderit të gjithëve mbledhjen e deklaroj të mbyllur, shihemi në mbledhjen e radhës.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Kryetar i Gr. Partisë Socialiste :

ROLANT XHELILAJ